



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

VENDIM

Nr. 69, datë 21.08.2020

PËR

**PËR SHQYRTIMIN E ANKIMIT ADMINISTRATIV TË PARAQITUR NGA
SUBJEKTI PERSON FIZIK PRENG DODA, KUNDËR VENDIMIT NR. 1 DATË
21.07.2020 VENDOSUR NDAJ SUBJEKTIT OSHMA "TV ME KABËLL
BESËLIDHJA".**

Autoriteti i Mediave Audiovizive
I përbërë nga:

Gentian	Sala	Kryetar
Sami	Nezaj	Zëvendëskryetar
Gledis	Gjipali	Anëtar
Suela	Musta	Anëtar
Agron	Gjekmarkaj	Anëtar

Mori në shqyrtim çështjen me:

Ankues: Subjekti person fizik Preng Doda
Objekt: Kundërshtim i vendimit për dënimin me gjobë të vendosur ndaj subjektit OSHMA "Tv me kabëll Besëlidhja", me nr. 1, datë 21.07.2020.
Baza Ligjore: Ligji nr. 97/2013 Për mediat audiovizive në republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Vendimi nr. 101 datë 07.06.2017 të AMA-s "Për procedurat e inspektimit të veprimtarisë audiovizive të ofruesve të shërbimit mediatic audio dhe/ose audioviziv. Kodi i procedruave administrative i Republikës së Shqipërisë. Ligji nr. 10 279, datë 20.05.2019 "Për kundravajtjen Administrative".

Grupi i inspektorëve të Autoritetit të Mediave Audiovizive, në zbatim të Urdhrit Nr. 115, datë 13.07.2020 të Kryetarit të AMA-s "Për inspektimin e veprimtarisë audiovizive të subjekteve (OSHMA), si dhe inventarizimin dhe sekuestrimin e pajisjeve të përdorura për ushtrimin e veprimtarive të palicencuara/paautorizuara nga subjekte të tjerë", në datën

17.07.2020, ka tentuar të kryejë kontrollin e veprimtarisë audiovizive të subjektit person fizik z. Preng Doda, në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë sipas legjislacionit përkatës në fushën e shërbimeve të transmetimeve audiovizive dhe shërbimeve të tjera mbështetëse të subjektit OSHMA “Tv me kabëll Besëlidhja”.

Grupi i inspektimit u paraqit rreth ores 11:30 në adresën ku subjekti person fizik Preng Doda ka të instaluar pajisjet audiovizive transmetuese të subjektit “Tv me kabëll Besëlidhja”. Në ambjentet e studios ndodhej një zonjë, e cila refuzoi të identifikohej si dhe nuk i mundësoi grupit të inspektimit kontrollin. Pavarësisht këtij fakti, grupi i inspektimit tentoi të komunikoi me vetë zotin Preng Doda në numrin e telefonit 0686491353, që subjekti ka depozituar pranë AMA-s për kontakt, si dhe në numrin e telefonit 0672029292. Z. Doda nuk iu përgjigj telefonatave si dhe mesazheve të inspektoreve për mundësimin e kontrollit në të dy numrat e telefonit. Disa çaste më vonë zonja që ishte e pranishme mbylli ambjentin ku janë instaluar pajisjet audiovizive transmetuese (studion e transmetimit) dhe u largua.

Sa më sipër pavarësisht se përfaqësuesi i subjektit që ishte prezent si dhe vetë zoti Preng Doda u njohën me urdhrin e inspektimit si dhe me pasojat e moslejimit të tij nuk mundësuan ushtrimin e kontrollit duke vepruar kështu në kundërshtim me Rregulloren “Për procedurat e inspektimit të veprimtarisë audiovizive të ofruesve të shërbimit mediatik audio dhe/ose audioviziv”, miratuar me Vendimin Nr. 101 datë 07.06.2017 të Autoritetit të Mediave Audiovizive.

Në Rregulloren “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së autorizimeve”, miratuar me Vendim Nr. 99 datë 07.06.2017 të Autoritetit të Mediave Audiovizive, neni 16, pika 2/b, parashikohet se:

Subjekti që pajiset me autorizim për ofrimin e njërit apo më shumë shërbimeve të parashikuara në këtë rregullore është i detyruar që:

Të garantojë prezencën e të paktën një punonjësi ose të një personi të autorizuar prej tij, në çdo kohë (24 orë në ditë, për 7 ditë të javës), në vendin/ambientin ku janë të vendosura pajisjet audiovizive dhe në çdo ambient ku emetohet sinjali i transmetimit audio dhe/ose audioviziv, si dhe të lejojë inspektimin e tyre nga inspektorët e AMA-s, në bazë të rregullores përkatëse të AMA-s “Mbi procedurat e inspektimit të veprimtarisë audiovizive të ofruesve të shërbimit mediatik audio dhe/ose audioviziv”

Nga sa më sipër, arrihet në përfundimin se subjekti nuk ka lejuar hyrjen e inspektorëve në ambientet ku subjekti ka të instaluar pajisjet audiovizive transmetuese të ofruesit të shërbimeve mediatike audiovizive (OSHMA) “Tv me kabëll Besëlidhja”.

Në nenin 78 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikohet se:

4. I licencuari dhe/ose i autorizuari duhet t'i paraqesë personit të autorizuar për kryerjen e inspektimit informacionin apo regjistrimet që zotëron lidhur me këtë kontroll, të lejojë hyrjen në mjediset e veta për të realizuar inspektimin dhe të ushtrojë këqyrjen e pajisjeve transmetuese në këto mjedise, si dhe, kur është e

nevojshme, t'u përgjigjet kërkesave të personit të autorizuar për ushtrimin e inspektimit me qëllim realizimin e tij.

Neni 133, pika 2/dh të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, përcakton se:

Shkeljet e mëposhtme, të kryera nga i licencuari ose i autorizuari, kur nuk përbëjnë vepër penale, janë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:

2. Me gjobë nga 120 000 deri në 2 000 000 lekë për rastet kur:

dh) ndalon hyrjen e inspektorëve në mjediset ku janë vendosur pajisjet audiovizive të të licencuarit dhe/ose të të autorizuarit ose nuk jepen të dhënat e kërkuara prej tyre;

Në këto kushte, ndaj subjektit në fjalë është proceduar me Vendimin nr. 1 datë 21.07.2020, duke e dënuar me gjobë atë në masën 2.000.000 (dy milion) lekë.

Kundër këtij vendimi, me shkresën nr. 2004/1 prot. datë 24.07.2020, subjekti ka paraqitur ankim administrativ, ndër të tjera duke pretenduar se:

- Në ambjentet e godinës së subjektit tv kabllor "Besëlidhja" është paraqitur një grup inspektorësh nga AMA për inspektimin e veprimtarisë audiovizive, ku në ambjentet e godinës ka qenë prezent arkëtaria e subjektit zonja Age Doda, e punësuar si arkëtare pranë subjektit kabllor Besëlidhja, e cila nuk ka dhe disponon asnjë informacion mbi mbarëvajtjen e punës në studion, menjëherë ka njoftuar përfaqësuesin e subjektit dhe njëkohësisht teknikun e studios, i cili i ka telefonuar inspektorit zotit Shkëlqim Bylyku, me nr kontakti 069217757. Pas telefonatës me zotin Shkëlqim Bylyku është rënë dakort për inspektimin në ambjentet e studios dhe kryerjen e pajisjeve transmetuese në këto mjedise, por që në asnjë moment pas telefonatës së teknikut të studios nuk është prezantuar asnjë nga grupi i inspektorëve të AMA-s. Pra jemi në kushtet kur grupi i inspektimit pasi ka komunikuar me teknikun e studios, i cili ka qenë i gatshëm për të mundësuar kryerjen e inspektimit ,por realisht nuk është paraqitur asnjë person për kryerjen e inspektimit.*

Pas njohjes me pretendimet e palës ankuese, konstatohet se ato janë të pambështetura në prova e ligj dhe nuk mund të justifikojnë mosrespektimin e parashikimeve ligjore. Ankuesi, pavarësisht faktit që nuk ka paraqitur asnjë provë që të justifikojë pretendimet e veta, pretendimet e paraqitura prej tij kundërshtojnë njëra tjerën, për shkak se, edhe pranon vetë faktin që një grup inspektorësh është paraqitur pranë subjektit të tij për kontroll, e më tej, pretendon se pas komunikimit me inspektorët nuk është prezantuar asnjë grup inspektimi. Në asnjë moment nuk është rënë dakort për kryerjen e kontrollit midis përfaqësuesit të subjektit dhe inspektorëve të AMA-s. Grupi i inspektimit, tentoi disa herë të komunikoi me z. Doda në dy numrat e telefonit, 0686491353 dhe 0672029292, dhe pavarësisht telefonatave si dhe mesazheve të inspektoreve për mundësimin e kontrollit, ai nuk i është përgjigjur. Ky fakt është lehtësisht i vërtetueshëm nga mesazhet e dërguara nga inspektorët e AMA-s.

PËR KËTO ARSYE,

Autoriteti i Mediave Audiovizive, në bazë të nenit 19, pika 16, nenit 133, pika 11 të ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative", si dhe rregullores "Për procedurat e inspektimit të veprimtarisë audiovizive të ofruesve të shërbimit mediatic audio dhe/ose audioviziv", miratuar me Vendimin nr. 101 datë 07.06.2017 të AMA-s, Autoriteti i Mediave Audiovizive.

VENDOSI:

1. Refuzimin e ankimit administrativ dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 1 datë 21.07.2020 për dënimin me gjobë, në masën 2.000.000 (dy milion) lekë, të subjektit person fizik Preng Doda, për subjektin OSHMA "Tv me kabëll Besëlidhja".
 2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatë, në përputhje me ligjin nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", duke filluar nga dita e marrjes dijeni.
 3. Ky vendim përbën titull ekzekutiv.
 4. Ngarkohet administrata e AMA-s për veprime të mëtejshme sipas ligjit.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar: **Gentian**

SALA

Zëvendëskryetar: **Sami**

NEZAJ

Anëtarë: **Gledis**

GJIPALI

Suela

MUSTA (Kundër gjobës)

Agron

GJEKMARKAJ